



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/139
Datë: 18.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 10 dhe 14 të Ligjit Nr.05/L-079 për Investimet Strategjike, nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.04/112 i datës 13 dhjetor 2022 me të cilin është konfirmuar vullneti i Qeverisë për t'i proceduar Kuvendit të Republikës së Kosovës Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 13/50, të datës 21 dhjetor 2020, për dhënien e Statusit Investitor Strategjik për Subjektin Investues "MOXICO LUMA KOSOVA MINING L. L. C" me Nr. 8628, të datës 19 nëntor 2020, për shkak të rrethanave të reja të konstatuara nga Komisioni, të cilat cenojnë interesin publik dhe bien ndesh me legjislacionin e aplikueshëm për investimet strategjike, si dhe me atë për miniera dhe minerale.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin e Qeverisë Nr.04/112 të datës 13 dhjetor 2022 dhe materialin me Nr. protokolli Nr. 3814-7/2020 ta tërheqë nga procedurat e Kuvendit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë